

Më datën 11 Shkurt 2022 në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit” në Tiranë u zhvillua analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore (VQV), e cila u fokusua në prezantimin e rezultateve të Departamentit për vitin 2021, por duke paraqitur gjithashtu edhe problematikat e shfaqura.

Të pranishëm në këtë analizë ishin Drejtores e Përgjithshme znj. Marjola Llanaj, Pas fjalës së hapjes së znj. Llanaj, njëkohësisht dhe në cilësinë e drejtorit të departamentit DAVQV u relatua mbi ecurinë e auditimeve ,pengesat e evidentuara gjatë vitit 2021 si dhe sfidat për gjatë vitit të ardhshëm.



Më pas, Kryeaudituesi i Departamentit Z. Berti Meçaj paraqiti raportin mbi veprimtarinë e Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2021, në të cilin përveç rezultateve të auditimeve apo sfidave për të ardhmen, përmendi edhe faktin se KLSH, nëpërmjet kryerjes së analizave po vitalizon praktikën e bashkëpunimit me institucione akademike, e cila është nevoja e ndërsjellë që palët kanë për informacion, në funksion të rritjes së besimit të publikut në institucionin e KLSH-së.

Gjatë vitit 2021 për DAVQV ishte planifikuar fillimisht kryerja e 20 auditimeve nga të cilat janë realizuar 46, si dhe janë në proces evadimi 7 subjekte. Në auditimet e evaduara të vitit 2021, 34 prej tyre kanë qenë auditime të kombinuara “Financiare dhe Përputhshmërie”, 9 auditime tematike “Për Pasqyrat Financiare” të vitit 2020, 2 auditime tematik mbi “Koncesionet-PPP, Shkolla Tiranë dhe Thumana” si dhe 1 auditim tematik mbi “Zbatimin e Rekomandimev” Në vlerësim të situatës, materialitetit, përhapjes së parregullsive dhe impaktit të tyre në miradministrimin e financave publike, nga 46 auditimet të kryera, janë dhënë opinion për “Pasqyrat Financiare” për 33 prej tyre: 7 janë opinione të pa modifikuar auditimi me theksim çështje, 16 janë opinione auditimi të modifikuar me rezervë dhe 10 janë opinione auditimi të modifikuar të kundërt.. Në fjalën e tij, Kryeaudituesi vuri në dukje se treguesi i lartë i opinioneve të modifikuara në masën 80 % tregon se në numër të konsiderueshëm subjektet e audituara kanë shfaqur mangësi të theksuara në menaxhimin ekonomik dhe financiar të veprimtarisë tyre, me pasoja në frenimin e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Në vitin 2021 për përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituara janë lënë gjithsej 2 rekomandime për ndryshime apo përmirësime ligjore në 1 subjekte, 685 masa organizative, 116 masa për shpërblim dëmi në vlerën prej 209,888 mijë lekë, 103 masa për efekte negative në menaxhimin me ekonomikitet, efience dhe efektivitet në shpenzime, në vlerën prej 2,594,556 mijë lekë. Nga auditimet e kryera në Bashkitë; Durrës, Lushnjë,

Shkodër, Pogradec, Kavajë, Kukës, Selenicë, Sarandë, etj., janë evidentuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkive në vlerën prej 9,676,703 mijë lekë. Gjithashtu, në vijimi të përpjekjeve për të ndryshuar klimën e mos ndëshkueshmërisë, janë rekomanduar masa disiplinore dhe administrative për ndëshkimin e personave të cilësuar përgjegjës në raportet tona të auditimit duke rekomanduar 74 masa administrative dhe 268 masa disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”.



Ndër dobësitë e shfaqura gjatë vitit të mëparshëm një vëmendje e shtuar do t'i kushtohet hartimit të programit të auditimit si dhe dokumenteve të raportimit të auditimit në mënyrë që ato të jenë të plota, të sakta, objektive, të bindshme, të qarta, koncize, dhe me një pamje të përshtatshme të kuptueshme edhe për opinionin publik.

Në përfundim u paraqitën objektivat për vitin 2022 si më poshtë:

- 1. Referuar nenit 50 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku përcaktohet se “Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm”, objektivi i Departamentit është përmbushja e kësaj kërkesë.
- 2: Zhvillimi i burimeve njerëzore në nivelin e parametrave të kërkuar nga standardet e INTOSAI dhe rritja e profesionalizmit të stafit auditues nëpërmjet realizimit të trajnimeve për stafin sipas normave të vendosura 2 vitet e fundit për ditë trajnimi në vit.
- 3: Grumbullimi dhe shfrytëzimi i ekspertizës më të mirë të fushës, nëpërmjet ndjekjes dhe zbatimit të marrëveshjeve të lidhura me organizatat e audituesve, kontabilistëve dhe me ekspertët kontabël.
- 4: Konsolidimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me Kuvendin e Shqipërisë si partneri kryesor i KLSH-së, dhe ku institucioni raporton lidhur me përgjegjshmërinë qeveritare të përdorimit të burimeve publike.
- 5: Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me aktorët jashtë vendit, përkatësisht me organizatat ndërkombëtare të auditimit si INTOSAI dhe EUROSAI, me SAI-t homologe të vendeve të BE-së, të vendeve të rajonit dhe në veçanti me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, duke shtuar veprimtarinë e trajnimeve dhe shkëmbimit të

eksperiencës, si dhe duke kryer edhe auditime të përbashkëta apo paralele, si në fushën e auditimit mjedisor etj.



Raporti i Drejtorit të Departamentit tu pasua me disa prezantime të audituesve z. Albert Hoxhalli dhe znj. Miranda Berdo, mbi punën institucionale si dhe rolin e KLSH në bashkëpunim me botën universitare. Seksioni i fundit i këtij aktiviteti ju rezervua pyetjeve dhe diskutimeve të audituesve të KLSH mbi përmirësimin e punës gjatë vitit 2022.